zunal.com

# MODELET E MESIMDHENIES

**WebQuest Description**: Nevoja per ta transformuar modelin e mesimdhenies tek femijet e klases 3-5
**Grade Level**: 3-5
**Curriculum**: Social Studies
**Keywords**:
**Published On**: 2010-06-28 08:17:15
**Last Modified**: 2010-06-29 04:29:12
**WebQuest URL**: http://zunal.com/webquest.php?w=62384

## Introduction

Ndryshimet shoqerore , ekonomike dhe politike kerkojne ndryshime edhe ne sitemin e arsimit me qellim te rritjes se cilesise se procesit edukativo-arsimor.
Ndryshimet kane te bejne me percaktimin e aktiviteteve programore dhe strategjive sipas nevojave dhe interesit te nxenesve dhe jo deshires se arsimtarit .
Ai duhet te perdore metoda te cilat ne praktrike njihen si metoda aktive , qe nxiasin forcen kreative te nxenesve , te vendose pratneritet te barabarte gjate komunikimit me nxensit , te stimuloje vetevleresim te punes se nxensve , te diagnostifikoje problemin e pastaj t'i planifikoje strategjite...
 Mendoj qe gjate viteve te fundit dukshem ka filluar te zhvillohet mesimi ne metoda te reja te cilat jane me te preferuara per nxenesit sepse puna qe bejene me kete model te mesimit ata jane me te kenaqur sepse procesi i mesimit zhvillohet me nje metod te re qe per nxensit eshte me atraktive dhe mesojne shume nga njeri-tjetri gjate punes se tyre ne grupe.
 

## Tasks

Sistemi arsimor dhe partneret e tij nuk jane arritur te prodhojne qytetare te cilet te mund te japin ndihmesen dhe te perfitojne nga nje bote qe ofron mundesi shume te medha por qe ne te njejten kohe paraqet edhe veshtiresi te medha per te gjetur rrugen ne te.Ndryshimi ne arsim eshte i nevojshem sepse shume nxenes nuk e duan shkollen e lene ose dalin keq ne mesime .Jeta e tyre eshte e varfer ngase duhet te jete.Ndryshimi ne arsim nevojitet sepse shume mesues nuk mund te durojn me jane merzitur dhe nuk u ka mbetur pike energjie.Ceshtja qe shtrohet sot eshte se si duhet te jete arsimi dhe shkollat qe ne t'i pergatisim njerzit per shoqerin e informacionit dhe si ta kapercejme kete transicion.
Transformim eshte ndryshimi i plote i pamjes se jashtme ose i karakterit te dickaje ose te dikujt.
Konceptet e ndryshimit jane:
1.sasia e ndryshimit mund te jete i madhe ose i vogel megjithate ai matet me ndikimin qe sjell ne shoqeri.
 2.kohezgjatja e ndryshimit sipas Fullan nje shkolle fillore mund te arrije te permiresohet per rreth 3 vjet .
 3.natyra e ndryshimit mund te jete e menjehershme ose e ngadalte.
 Ne tani po jetojme ne kohen e tranzicionit nga shgoqeria industriale ne shoqerin e informacionit .
Keto ndryshime mund te jene :
 a.qe dedikohen nga ndryshime ekonomike e sociale
 b.nga rritja e diversitetit te popullates se siles i sherben shkolla
 c.nga konceptimet e reja per te nxenet dhe njohjen.
 

## Process

 Menaxhimi i klases nuk eshte nje gje tjeter  vecse zbatimi dhe perdorimi I te gjitha rregullave dhe procedurave per sigurimin e rregullit , disciplines dhe mbarevajtjes te mesimit ne klase.Qe menaxhimi te jete sa me i efekteshem duhet te zbatohen disa teknika te tij.Keto teknika te menaxhimit ne klase fillojne qe ne fillim te shkolles;
 -mesuesi tregon se eshte i pergatitur per nje pune te gjate qe e pret perpara dhe se ka besim tek vetja per te realizuar qe ne diten e pare te shkolles.
 - mesuesi fillon mesimin ne diten e pare te shkolles me nje detyre e cila eshte e qarte dhe mund te kryhet ne menyre te suksesshme nga nxenesit.
 - mesuesi demonstron ne menyre te vazhdueshme se eshte kompetent i pergatitur mire dhe se eshte ne krye te punes.
 -         mesuesi duhet te jete profesioniste i kendeshem dhe te perpiqet qe te krijoj nje atmosfer miqesore me nxnesit ne klase.
 -         mesuesi duhet te tregoj se eshte ne korent me gjithcka qe ndodh ne klase , kjo bene qe keta mesues te kene me pak probleme ne klase duke i krahasuar me ata mesues qe nuk jane ne dijeni te asaj qe ndodh ne klase.
 -         mesuesi duhet te jete i afte per t'u marre me shume gjere ne te njejten kohe.Duhet ruajtur ritmi i duhur i veprimtarive ne klase.Mesuesi duhet te beje nje analize te punes te tij ne kete moment i duhet te mendoj se si e ka menaxhuar klasen gjate nje periudhe te caktuar te dites mesimore.

 -         Mesuesi duhet te perpiqet te perfshij ne mesim te gjithe nxensit edhe ateher kur ai punon me nje nxenes te vecant.
 -         Mesimi duhet organizuar me variacione .Ne rastet kur shihet se ne oren e mesimit nuk shkon dicka , mesuesi duhet te perpiqet te ndryshoje materialin qe eshte duke dhene ,duke bere te lehte dhe me te kuptueshem per nxenesit.
 Menaxhimi i klases ka lidhje te ngushta me sjelljen e mesuesit.Per kete mesuesi duhet te jete i drejte me nxenesit te zoteroje mire lenden ,te kontrolloj emocionet e tij , te ndihmoje nxenesit ne rast nevoje ,te ndjek ecurin e nxenesve gjate kryerjes se deetyrave etj...Nga pervoja e vezhgimeve mund te themi se mesuesi yne , jo rralle humbet shume kohe ne oren e mesimit ,humbje e cila ndodh jo vetem si rrjedhoje abuzive,po mbi te gjitha nga aftesite e kufizuara menaxhuese te klases .
Mesuesi yne ende nuk e ka kuptuar se ne kushtet e zhvillimit te vrullshem shoqeror dhe te rritjes mahnitese te informacionit koncepti per mesimdhenien ka ndryshuar .Mesuesi nuk mund te luaj me rolin e burimit te informacionit si dikur , por ai ne menyre te pashmangshme eshte pozicionuar si udheheqes dhe organizues i mesimit qe udheheqe nxenesin per te kerkuar e mbledhur informacionin ne menyre te drejtuar apo te pavarur duke e paisur me metodologjine e studimit dhe perpunimit te ketij informacioni.
Pikerishte ne keto momente shfaqet aftesia e menaxhimit te klases nga ana e mesuesit aftesiaa e cila duhet te karakterizohet nga vezhgimi i kujdesshem ,vleresimi i sjelljeve ne klase , gadishmeria per t’u pergjigjur ne kohe sjelljeve te papershtatshme duke u prire drejt krijimit dhe ruajtjes se nje klime pozitive dhe sa me shume te pershtatshme ne procesin e mesimdhenies ne klase.
 
 

# Evaluation

 Opinione te mesuesve ne fillim me eshte dukur se metodat klasike jane te pazevendesueshme por shume shpejt kuptova se te nxenet nderveprues te gjitha ato teknika ne menyren me te persosur i nderrojne metodat klasike . Gjate ores te gjithe nxenesit jane aktiv shume te lire dhe pjesemarres te barabarte ne mesim .Pas perdorimit te ketyre metodave dhe teknikave edhe suksesi ne klase dukshem u permiresuar edhe nxenesit e dobet ju bashkengjiten atyre te mireve .......
 Anet pozitive te ketyre metodave dhe te formave te te nxenit jane te shumta:
 Shembull ;
1.nxenesit shprehin deshire te madhe te punojne ne grupe sepse ndihen te lire , deshirojne te bashkepunojne dhe te shprehin idete e tyre.
2.para se ti vleresojme ne ata vleresojne njeri – tjetrin.
3.prinderit shprehin kenaqesi dhe pajtim me kete pune,me metoda te reja.
4.por ora mesimore shpesh eshte e shkurter prej 45 min
......duke i zbatuar teknikat e reja te te nxenit nderveprues punen kryesore e bejne vete nxenesit me ane te aktiviteteve , lojrave , punes  me grupe dhe zoteron me shume lenden.
 Ata u shprehen se metodat jane mjaft interesante , mesimi eshte mjafte i kuptueshem si per ne por gjithashtu edhe per te gjithe nxensit e shkollave tjera . Me kete metode ne jemi me atraktiv gjate procesit mesimit dhe mesojm shume nga njeri – tjetri sepse puna ne grupe eshte shume e qelluar .
Pra puna ne grupe eshte shume e mire sepse i ndihmon shume nxenesve te dobet sepse momentin e zbatimit te ketij modeli qe ju eshte ofruar mesimdhenies tone edhe nxensit e dobet jane avancuar shume dhe ju ka ndiohmuar atyre qe mesimin ta kuptojn me mire dhe me lehte permes kesaj metode.
 Po verehet ndryshimi tek femijet tane, do te thote shume me lehte po e kuptojne mesimin dhe jane te kenaqur shume me keto metoda qe zhvillohen ne shkolle kjo verehet dukshem ne shtepi sepse jane me afer qellimit dhe ides se cka kane mesuar ne shkolle e kan nje vullnet me te mire sidomos ne punen me grupe sepse aty te ky model ata e kane gjete veten shume mire sepse ndihen te lire te shprehen ashtu si din dhe si e kane kuptuar mesimin.
Ne si prinder jemi te kenaqur me kete model te mesimit dhe ju deshirojme qe edhe me tutje te punohet ne kete drejtim.
 
 

| Category and Score | | | | | Score |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | Total Score | |

# Conclusion

Erdhem ne konkluzion dhe ne perfundim se permes ketij modeli te mesimdhenies arritem qe ta percjellim nje model te ri tek nxenesit , me kete metode ata ishin me atraktiv gjate procesit mesimore dhe ishin te barabarte mesimdhenien , kjo ide ishte e qelluar per mendimin tim sepse vereheshin nxnesit ne grupe gjate punes te kenaqur.
Gjithashtu nxenesit kishin mesuar qe ta vleresojne njeri - tjetrin , per punen qe ata e zhvillonin ne grupe gjate ores se mesimit dhe ti bejne pyetje ne mes grupeve qe punoni dhe para se te vlereson pra messuesi ata e vleresonin njeri - tjetrin kjo ishte nje perparesi shume e mire per nxenesit sepse edhe nxenesat me te dobet filluan te jene me atraktiv sepse puna ne grupe i avancoj edhe ata me te dobetit se ne mes grupit e kishin edhe ata mundesin qe te japin pergjigjje dhe te angazhoheshin me shoket e tyre .
Reflektimi behet zakonisht ne fund te vitit sepse e kemi gjithe permbledhjen dhe sukseset e punes se tyre per ti vleresu dhe qe te

japim nje perfundim per nxenesit duhet pra qe refleksionin ta bejme ne fund vite.
 

# Teacher Page

 Mesuesi duhet te dije gjithashtu te percaktoje kerkesat per cdo nxenes dhe te pershtatet ne larmine e tyre me ane te zhvillimit te planeve te veprimit pedagogjik te shumellojshem duke patur parasysh arritjet dhe kapacitetet vetiake.
Kurrikula shkollore shpeshhere duhet zgjerohet nga vete mesuesi p.sh. ne klasen e pare kur nxenesit njohin shkronjat , lexojne dhe shkruajn ndonese sapo kane hyre ne klasen e pare.Nje mesues i suksesshem duhet te kujdeset ne vecanti per keta nxense duke hartuar e zbatuar nje plan te vecant per pune ne pershtatje me nivelin dhe deshirat e tyre per te mesuar.
Mesuesit qe punojne ne ciklin fillore theksojne faktin se natyra e vertete e mesimdhenies se tyre ndryshon vazhdimisht . Ajo behet me emocionale e kenaqshme e kendshme dhe me nivel me te larte intelektual , kur sigurohen pjesemarrje e gjere e nxenesve ne mesim.Si edukator duhet te mbajme parasysh se c’do nxenes qe ne mesojme eshte individe , produkt i kultures , i mjedisit , i shendetit , i temperamentit dhe i personalitetit te vecante.
. -         ndjekin deshirat e nxnesve duke sugjeruar fushat me me interes per t’u mbajtur parasysh gjate zbatimit te projekteve ne zhvillim duke krijuar keshtu mesime tematike dhe duke vene veten ne pozitat e nxnesve gjate gjithe kohes se veprimatrise se perbashket.Pra mesuesi mund te nxit mesimnxenie te re duke sjelle burime e informacione ne cdo kohe te punes ne oren e mesimit dhe jashte saj.
 -         fillojne zhvillimin e mesimit duke drejtuar pyetje per paqartesi qe mund te kene nxenesit.Kjo sherben per te marre te dhena per shkallen e informacionit qe kane ata rreth konceptit qe do te trajtohet.Me tej nepermjet bashkebisedimit nxjerrjen se c’fare duan te dine nxnesit dhe si mund te pervetesojne keto njohuri koncepte qe permban tema.
 -         Nxitin nxnesit te bejne pyetje te perfshihen ne diskutim dhe te perpunojne pergjigjjet e tyre.Ata mbeshtesin strategjite e te mesuarit te nxnesve dhe tregojne respekt per ta duke u lene kohe te mjaftueshme per tu pergjigjur.
 Karakateristika te tilla mund te ndeshen edhe ne pune te perditshme.Ato tregojne se mesuesi qe i zbaton , perdore forma te reja ne trajnimin e zhvillimin e mesimit.Ai shmanget keshtu nga format e njohura tradicionale nepermejte te cilave nxenesi trajtohet vetem si objekt i procesit mesimor.
 

**Standards**

**Credits**

**Other**